



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

VENDIM

Nr. 18, Datë 02.11.2020

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË INSTITUTIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E SISTEMIT TË ZGJEDHJEVE, PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR MBLEDHJEN E NËNSHKRIMEVE MBËSHTETËSE PËR PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR REFERENDUMET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në paragrafin 2 të nenit 19 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenet 33, 42, 47, 53, 87 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur dhe diskutimet e përfaqësuesve të komitetit të nismës ligjvënëse;

V Ë R E N

Instituti Shqiptar për zhvillimin e sistemit të zgjedhjeve, me përfaqësues të nismës ligjvënëse të zgjedhësve z. Kristaq Kume, zj. Brisida Gjirkondi dhe zj. Eneda Bozheku kanë paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën për pajisje me fletë tip për propozimin e projektligjit “Për Referendumet në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 11, datë 30.06.2020 vendosi miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve sipas kërkesës së Institutit Shqiptar për Zhvillimin e sistemit të zgjedhjeve, për propozimin e projektligjit “Për referendumet në Republikën e Shqipërisë”.

Vendimi i sipërcituar, ka përcaktuar afatin 3 mujor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për mbledhjen e nënshkrimeve. Afati përfundimtar për depozitimin e fletëve për mbledhjen e nënshkrimeve për t’u depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nga përfaqësia/ komiteti përfaqësues i nismës, është data 30.09.2020.

Në datën 01.10.2020 pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është protokolluar kërkesa për shtyrjen e afatit të përcaktuar në vendimin e sipërcituar, për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme nga komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse. Kërkesa është dërguar me postë me datë 30.09.2020.



Në datën 02.11.2020, në mbështetje neneve 33, 42, 47, 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodit të Procedurës Administrative, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve thirri si palë në këtë shqyrtim administrativ, përfaqësuesit e Institutit Shqiptar për zhvillimin e sistemit të zgjedhjeve z. Kristaq Kume, zj. Brisida Gjikonci dhe zj. Eneda Bozheku, për të dhënë mendime dhe shpjegime për kërkesën në seancën dëgjimore.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me datë 02.11.2020, ora 11:00 zhvilloi seancën dëgjimore ku ishin të pranishëm përfaqësuesit e komitetit përfaqësues të nismës ligjvënëse të cilët parashtruan se;

- 1- Komiteti përfaqësues e ka patur të pamundur mbledhjen e nënshkrimeve për shkak të pandemisë Covid-19.
- 2- Urdhërat dhe masat e marra nga Ministria e Shëndetësisë në kuadër të masave për mospërhapjen e virusit Covid-19, që janë ende në fuqi, ka vënë në vështirësi komitetin përfaqësues për mbledhjen e nënshkrimeve, pasi nuk lejoheshin grumbullimet.

Duke vlerësuar se situata e pandemisë vazhdon të jetë ende kështu, kërkojmë shtyrjen e afatit për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme për propozimin e projektligjit “Për Referendumet në Republikës së Shqipërisë”, deri në Mars 2021.

Sa më sipër, ligji nr. 54/2019 “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë” nuk parashikon afat konkret për mbledhjen e nënshkrimeve në vende publike apo private si edhe të nënshkrimeve elektronike. Në këto kushte, afati 3(tre) mujor i përcaktuar me vendimin nr. 11 datë 30.06.2020 për mbledhjen e nënshkrimeve në vende publike apo private si edhe të nënshkrimeve elektronike, është përcaktuar nga organi që ka shqyrtuar kërkesën në kohë, pra Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sipas parashikimeve të paragrafi 2 të nenit 53 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Paragrafi 3 i nenit 53 “Përcaktimi dhe shtyrja e afatit procedural”, të Ligjit nr. 44/2019 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” parashikon shprehimisht se:

“...afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në mbështetje të paragrafit 3 të nenit 53 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe duke marrë në konsideratë se kërkesa është dorëzuar pranë Komisionit Qendror të zgjedhjeve përpara mbarimit të afatit 3 mujor si edhe justifikimet dhe argumentet e parashtruara nga ana e kërkuarës në këtë seancë vlerëson si të ligjshme kërkesën për zgjatjen e afatit për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për projektligjin “Për referendumet në Republikën e Shqipërisë”.



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në paragrafin 2 të nenit 19 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe paragrafit 3 të nenit 53 të ligjit 44/2015 “Kodi Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S A:

- 1- Të zgjasë afatin për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për projektligjin “Për Referendumet në Republikën e Shqipërisë”, deri në datën 28 Shkurt 2021.
- 2- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- 3- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Erjan CELIBASHI



Nr . 18 i vendimit

Data 02.11.2020 e vendimit

Për shqyrtimin e kërkesës së Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Zgjedhjeve “Për shtyrjen e afatit për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për propozimin e projektligjit “Për referendumet në Republikën e Shqipërisë”.